



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA E PATOS

KRYETARI
SEKTORI I PROKURIMEVE PUBLIKE

Nr. _____ Prot.

Patos, më 12/12/2023

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “BLERJE BAZË MATERIALE PËR ZGJERIM RRJETI
K.U.Z”.**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Hekur me kod 14711000-8 Materiale ndertimi dhe produkte te ngjashme me Kod 44100000-1

Tuba betoni me kod 44114220-0 kapake me kod 44618340-0.

VLERA E FONDIT LIMIT: 1,950,000 (një milion e nëntëqind e pesëdhjetë mijë) lekë pa tvsh, venë në dispozicion nga të ardhurat lokale 2023.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Patos** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2020, 2021, 2022, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se **780,000 (shtatëqind e tetëdhjetë mijë)** lekë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

1,950,000 x 40% = 780,000 Lekë.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohej, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike". Në përcaktimin e vlerës së xhiros autoriteti kontraktor është referuar në pikën 2, gërma (c) të Nenit 43, Seksioni III të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2.2 Vërtetim lëshuar për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2023, kudo ku operatori ushtron aktivitet, sipas regjistrimit në QKB, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, lidhur me afatet e kryerjes së pagesave të caktuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore për vitin 2023.

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anetar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Bashkia në të cilën është regjistruar sipas QKB-se).

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi fitues përpara dhënies së kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2 d).

Referuar sa më sipër, njësia e prokurimit gjykon se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të vertetimit të shlyerjes së detyrimeve vendore për vitin 2023 prane bashkise/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për tju nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate (apo shumatores së fondit limit të loteve, nëse kontrata është e ndarë në lote dhe ofertohe për më shumë se një lot).

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se ... % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

1,950,000 x 20% = 390,000 Lekë.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohej, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

2.3.2. Operatori ekonomik duhet të vetdeklaroj se merr përsipër furnizimin (dorëzimin ngarkimin dhe shkarkimin) e mallit objekt prokurimi në Magazinën e Agjencisë së Shërbimeve Publike Patos në prani të komisionit të ngritur për marrje në dorëzim.

ARGUMENTIM: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 8, të nenit 40 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”. Ky vetdeklarim kërkohej për ti vertetuar dhe garantuar AK-së realizimin me sukses të kontratës përse i përket dorëzimit të mallrave objekt prokurimi.

2.3.3. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës dhe transportin e materialit, duhet të disponojë në pronësi ose me qera, mjetet e mëposhtme:

- Kamion me karroceri me gjatësi jo më pak se 8 m **copë 1**
- Kamion vetshkarkues **copë 1**

Ofertuesi për makineritë, të cilat janë në pronësi ose qera (me kontratë noteriale), duhet të paraqesë, dokumentacionin e mëposhtem:

- lejen e qarkullimit.
- certifikatat e pronësisë,
- siguracionin e mjetit,
- kolaudimin,
- certifikatë transporti
- fotografi të mjetit të paraqitura. (të cilat duhet të jenë në emër të shoqërisë ose në emër të qeradhënësit).

Për mjetet dhe pajisjet të cilat nuk kanë leje qarkullimi, Ofertuesi duhet të paraqesë:

- kontratë noteriale të blerjes,
 - fatura tatimore të blerjes ose dokumenta zhdoganimit të mjetit.
- a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit, leje qarkullimi, plus certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshme), dhe për mjetet e siguruar me qera,*

dokumenti që vërteton regjistrimin e tij, leje qarkullimi, plus certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit, (të vlefshme), të shoqëruar me kontratën përkatëse të qerasë/furnizimit noteriale, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.

- b) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre.**

Shënim:

Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikës 5/ç nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, mjetet dhe pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Këto mjete janë kërkuar nisur nga sasia e konsiduereshme e mallrave objekt prokurimi. Gjithashtu furnizimi i sasisë së materialit objekt prokurimi kërkon si nevojshmëri për realizimin e kontratës dy kamionët cilët do të shkarkojnë materialin në objektet përkatëse në prani të komisionit dhe stafit teknik të Agjencisë së Shërbimeve Publike të cilët do të kryejnë proceset e tjera.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Blerja e tubove të brinjëzuara dhe tubove betoni do të shërbejnë për zgjidhjen e problemeve të akumuluar gjatë viteve në rrjetin e kanalizimeve në qytetin e Patosit, zgjerim rrjeti kuz dhe përmirësim të dimensioneve aty ku ka shtesë të prurjeve të ujërave të zeza, rrjedhje në terren, shkarje të rrjetit etj.

Mbulimi i pusetave do të jenë me kapak gize me diametër 60 cm. Ndërtimi i pusetave do të bëhet me beton C16/20.

Punimet e gërrimit për shtrimin e linjave të kuz do të përballohen nga Agjencia e Shërbimeve Publike.

Agjencia e Shërbimeve Publike duhet të mbajë dokumentacionin tekniko-ligjor si:

Libreza e masave, ditarin e punimeve, situacionet e punimeve të kryera, procesverbal për punimet e maskuara, libër i sigurimit teknik dhe foto gjatë procesit të punës.

Tubot e brinjëzuara që do të blihen janë HDPE SN 4, me diametër Ø200, Ø315, Ø400 sipas përcaktimeve në hartën treguese bashkëlidhur dhe duhet të jenë të kompletuara me fashetat dhe gominat përkatëse për montimin e tyre.

Tubot e betonit do të jenë me diametër Ø600, Ø1000, Ø1200 sipas përcaktimeve në hartën treguese bashkëlidhur.

Punimet për rrjetin e kanalizimeve do të kryhen nga Agjencia e Shërbimeve Publike.

Afati i dorëzimit të bazës materiale nga operatori ekonomik fitues do jete 20 ditë nga lidhja e kontratës midis operatorit dhe Bashkisë Patos.

Operatori ekonomik fitues duhet të njoftoj 24 orë para dorëzimit të mallit.

Materiali do të jetë sipas zerit në preventiv.

Shënim:

Malli do të dorëzohet në prani të komisionit të ngritur me urdhër të titullarit dhe magazinierëve së Bashkisë Patos dhe Agjencisë së Shërbimeve Publike në magazinën e Agjencisë së Shërbimeve Publike.

Është menduar ndërhyrja në disa segmente si :

- 1- Zgjatim i rrjetit kuz në Lagjen e Re, pranë Bar Gjermani, është një segment me gjatësi 50 ml ku depozitohen ujërat e zeza që shkarkohen nga blloku i lagjes së Re nga Pallati i Kulturës deri në afërsi të përroit. Do të bëhet zgjatimi i kanalizimit me tubo betoni me diametër d=1000 mm.
- 2- Zgjatim i rrjetit kuz në Lagjen Grizë Gropallar, është një segment me gjatësi 50 ml ku depozitohen ujërat e zeza që shkarkohen nga blloku i lagjes. Do të bëhet zgjatimi i kanalizimit me tubo betoni me diametër d=1200 mm.
- 3- Zgjatim rrjeti kuz në lagjen e Re, segment me gjatësi 132 ml do të ndërhyhet me tubo betoni me diametër d= 600mm, Në këtë seksion depozitohen ujërat e zeza të lagjes Banaj.
- 4- Zgjatim rrjeti kuz në lagjen Dukas 3, segment me gjatësi 200 ml ku depozitohen ujërat e zeza të lagjes Dukas deri në afërsi të rrugës Sotir Xoxe. Do të bëhet zgjatimi i tubacionit me diametër d= 400 mm. Për kontrollin e këtij kanalizimi do të ndërtohen puseta me dimensione 1m x 1m x1 m.

- 5- Ndërtim rrjeti kuz në lagjen Dukas Kripallarë e cila do të shërbej për disiplinimin e ujërave të zeza . Do të bëhet me tubo të brinjëzuara HDPE me diametër 200, 315 dhe do të bëhet kontrolli i linjës me puseta kontrolli me dimensionin 0.8*0.8*1 m çdo 30, 35 m. Segmenti është me gjatësi 200 ml.
- 6- Rrjeti kuz në lagjen Dukas Çoban, rruga Sotir Xoxe do të bëhet zgjatimi i shkarkimit të ujërave të zeza me tubo të brinjëzuara HDPE me diametër 400 me një gjatësi 200 ml dhe do të bëhet kontrolli me puseta me dimensione 1m*1m*1m.
- 7- Zgjatim rrjeti kuz në lagjen 29 Marsi në një gjatësi 70 ml me tubo të brinjëzuara d=315mm. Në këtë seksion bëhet shkarkimi i ujërave të zeza në kanal të hapur në afërsi të banesave. Shkarkimi i tyre do të bëhet në përrua në largësi të zonave të banuara.
- 8- Në fshatin Margëlliç shkarkimi i ujërave të zeza bëhet në kanale betoni të hapura të cilat kalojnë në afërsi të banorëve të lagjes, është menduar ndërtimi i kapakëve të betonit për eliminimin e ajrit të ndotur.

Blerja e tubove të brinjëzuara dhe tubove betoni do të shërbejnë për zgjidhjen e problemeve të akumuluar gjatë viteve në rrjetin e kanalizimeve në qytetin e Patosit, zgjerim rrjeti kuz dhe përmirësim të dimensioneve aty ku ka shtesë të prurjeve të ujërave të zeza, rrjedhje në terren, shkarje të rrjetit etj.

Mbulimi i pusetave do të jenë me kapak gize me diametër 60 cm. Ndërtimi i pusetave do të bëhet me beton C16/20.

Punimet e gjërmimit për shtrimin e linjave të kuz do të përballohen nga Agjencia e Shërbimeve Publike.

Specifikimet dhe kriteret teknike u hartuan nga **Drejtoria e planifikimit urban, projekteve, shërbimeve dhe emergjencave civile** duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, në përputhje me përcaktimet e nenit 36 “Specifikimet teknike” të Ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, e Nenit 40 pika 2, si edhe të Nenit 44 “Kerkesat e cilesise” të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Në përfundim, Njësia e Prokurimit vendosi unanimisht miratimin e dokumenteve të tenderit dhe si afat përfundimtar për dorëzimin e ofertave përcaktoi datën **26/12/2023, ora 11:00**.

Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit me objekt **“Blerje bazë materiale për zgjerim rrjeti K.U.Z”**.

Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurimin anëtar në NJP.

Bashkëlidhur këtij procesverbali:

Dokumentat e tenderit.

NJESIA E PROKURIMIT